

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i pergjithëshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit L. N., nga Prizreni, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore ne Prizren PP.nr.2710-4/16 të datës 30.11.2016, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KP-ës, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së, për dhënien e urdhrin ndëshkimor me datë 29.08.2017, muarr këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L. N., nga i ati H. dhe nëna A. e lindur K., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe tani jeton në rrugën ..., pa numër, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datën 22.10.2016, rreth orës 14,30 – 22,00, në Prizren, në lagjen “A.”, blen, pranon, fsheh apo në ndonjë mënyrë tjetër siguron pasurinë për të cilën ka mundur ta dijë se është përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që nga E. K. blen një televizor të markës “Hugo”, një modem me kartel, një mbushës, për modem dhe një për wifi, një copë kabllo, të cilat pajisje E. K. ka pranuar se i ka vjedhur në një shtëpi,

- këso dore ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KP-ës,

- Andaj, gjykata me aplikimin e dispozitave të nenit 4, 41, 43 par. 1 pika 1.3, nenit 46, 73 të KPK-ës dhe neni 495 të KPPK-ës jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

- **PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.2710-4/16 të datës 30.11.2016, ashtu që.

Të akuzuarit **L. N.**, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 200 € (dyqind) euro, të cilin denim i akuzuari duet të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të zavendesohet me dënim burgimi duke llogaritur për çdo 20 € një ditë burg.

I akuzuari obligohet që të paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe ate në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20,00 euro, të gjitha në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate, i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2710-4/16 të datës 30.11.2016, kundër të akuzuarit L. N., nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KP-ës, dhe kërkesën për lëshimin e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetim se janë siguruar të dhëna të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale i cila i vihet në barë dhe janë plotësuar kushtet ligjore kon forme nenit 493 të KPPK-ës për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit të kërkesës të PTH-ës në Prizren për dhënien e urdhrin ndëshkimor konstatoi se ka të dhënat mjaftueshme të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor, andaj gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore dhe mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kjo gjykatë konsideron se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë në raportin e oficerëve me nr. 2016-GL-212, të datës 23.10.2016, të përpiluar nga oficeri A. K., si dhe të oficerit R. Z., procesverbal mbi bastisjen e banesës dhe personave, vërtetim mbi sekuestrimin e sendeve përkohësisht në deklaratën e të pandehurit, në deklaratën e E. K., të dhënë në procedurën paraprake pranë Stacionit policor në Prizren, si dhe në shkresat e tjera të lëndës vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale i cila i vihet në barë.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale u muar në bazë të nenit 450 dhe 451 par. 1 të KPPK-ës.

Me sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimit

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN P.nr.2625/2016 të datës 29.08.2017.

**Procesmbajtësja
Naxhis Sharani**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Luan Berisha**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit, në këtë gjykatë. Po qesë i pandehuri nuk ushtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.